



Business Support on Your Doorstep



## Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme përballë vështirësive të krizës së Covid-19

Prof. Dr.Arben MALAJ, Msc.Leonardo ABAZAJ

### Abstrakt

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) prej kohësh janë pranuar si motorët e rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Ndikimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme edhe në ekonominë globale është shumë i rëndësishëm për rritjen e punësimit dhe reduktimin e varfërisë. Arsyeja është se ato jo vetëm që ofrojnë mundësi të shumta punësimi për shtresat e ndryshme të shoqërisë, por njëkohësisht janë aktivitete ku paraja qarkullon më shpejtë duke patur kështu një impakt të drejtëpërdrejt në rritjen e ekonomisë. Studimet tregojnë se NVM-të kanë potenciale të pa përdorura të cilat duhen identifikuar, mbështetur dhe promovuar për ti futur në qarkullim ekonomik duke ushqyer një rritje ekonomike më të lartë, të qëndrueshme, produktive dhe të drejtë nga pikëpamja sociale.

Rritja e NVM-ve shoqërohet më rritje të punësimit duke zbutur një nga problemet më të rënda sociale që është papunësia. Një nga avantazhet e NVM-ve është fleksibiliteti i tyre. Kjo i bënë të jenë më pak të prekur nga krizat dhe me mundësi më të shpejta dhe më të lehta për tu ringritur. Ato përfaqësojnë një mundësi të pa përdorur plotësisht në ristrukturimin dinamik të ekonomive të vendeve tona. Ato vlerësohen për avantazhet e tyre por edhe për risqet potenciale. Evidentimi i avantazheve sipas vendeve konkrete dhe qartësimi i pikave të dobëta ndihmon në cilësinë e politik-bërjes, si dhe në krijimin e një ambienti mbështetës për individët që marrin risk të fillojnë biznesit e tyre në trajtë të micro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë kohë që për shkak të fatkeqësive natyrore në rritje, paqartësitë dhe pasiguritë tek individët, tek konsumatorët, tek mikro-ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë rritur konsiderueshëm. Megjithatë në periudhë krizash NVM-të shihen si një faktor kyç pasi kërkojnë më pak burime njerëzore dhe financiare për tu pershtatur me kushtet e krijuara.

Fjalët Kyç: NVM, novacion, punësim, avantazhe krahasuese

### Hyrje


NVM-të vlerësohen si shtylla “kurrizore” e ekonomive të shumë vendeve. Ato përfaqësojnë 80- 95% të numrit total të ndërmarrjeve, kontribuojnë me rreth 60-75% të prodhimit të brendshëm bruto si dhe rreth 65-80% e të punësuarëve gjenden pranë tyre. Ky kontribut i konsiderueshëm imponon njohjen e avantazheve dhe disavantazheve të NVM-ve, për të ndërtuar politika proaktive në mbështetje të tyre dhe për të ndërtuar programe kombëtare për reduktimin e pengesave të zhvillimit të NVM-ve. Kriza Covid-19 është specifike në përmasat e përhapjes së saj, në ndikimin e çdo qelize ekonomike, nëpërmjet bllokimit të aktivitetit ekonomik, ndërprerjes së zinxhirit global të blerjeve dhe shitjeve të mallrave dhe shërbimeve, ndalimin për një kohë jo të shkurtër të daljes fizike të individëve dhe punonjësve. Në këto rrethana ka interes studimi i paketave fiskale anti Covid 19, duke njohur dhe krahasuar përvojat e të gjitha vendeve lidhur me paketat sociale dhe paketat për rindezjen e ekonomisë dhe në veçanti se cilat kanë qënë përvojat e sukseshme për NVM-të. Në kushtet kur pasiguritë dhe paqartësitë po bëhen më të shpeshta studimi i eksperiencave, strategjive, politikave dhe instrumentave të daljes nga krizat janë një vlerë e shtuar për të përmirësuar politik-bërjen, sidomos në qartësimin e: (i) domosdoshmerisë për të ndërhyrë sa më shpejtë dhe sa më fortë; (ii) strukturave të paketave fiskale; (iii) madhësinë e tyre dhe (iv) kohëzgjatjen e tyre.

### Roli i NVM-ve në BE

Duke qënë se pesha e NVM-ve në Shqipëri si dhe kontributi i tyre në rritjen ekonomike; punësimin dhe të ardhurat në buxhet është e përafërt me ato të vendeve të **Ballkanit Perëndimor** dhe deridiku edhe me vendet e BE, vlen të analizojmë trendet kryesore të NVM-ve në 28 vendet e BE-së për të njohur se ku duhet të synojnë politikat publike pro NVM-ve, pasi në këtë mënyrë qartësohen avantazhet dhe disavantazhet, qartësohen diferencat e mëdha midis 28 vendet si edhe identifikohen këshillat orientuese edhe për vetë NVM-të.

**Roli i NVM-ve në krijimin e vendeve të punës** - Pavarësisht se luan një rol jetësor në zhvillimin e ekonomisë, vërehet se rreth 50% e NVM-ve kanë mungesë të qasjes në financa ose investime kapitale. Në çdo moment të caktuar, NVM-të formale krijojnë rreth 33% të të ardhurave kombëtare dhe 45% të punësimit të përgjithshëm në vendet në zhvillim. Për të arritur në një analizë të paketave ndihmëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të duhet të qartësojmë kontributin e tyre në ekonominë e vendeve të ndryshme. Njohja e këtij kontributi ka si parakusht unifikimin e klasifikimit se kush përfshihet në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në nivel kombëtarë dhe në nivel evropian<sup>1</sup>, pasi vende të ndryshme përdorin klasifikime të ndryshme për NVM-të.

**Grafiku1:** Të punësuar me kohë të plotë në ndërmarrje të vogla dhe të mesme (132 vende)



**Burimi:** ILO's World Employment


<sup>1</sup> <https://ec.europa.eu/eurostat/web/structural-business-statistics/structural-business-statistics/sme>

## NVM-të përballë vështirësive të krizës së Covid-19

Në vendet e BE-28 në 2018 kishte rreth 25 milion NVM ku 93 përqind janë mikro, numri i të cilave varion nga 29/1000 banorë në Rumani në 115/1000 në Ceki.. Në totalin e ekonomisë përfshirë edhe sektorin financiarë NVM-të prodhojnë 54% të vlerës dhe 66.6% të punësimit.

Aktualisht vetëm 28.4 % e NVM-ve janë të fokusuara në sektorë që kanë një orientim të fortë me industrinë e bazuar në ekonominë e dijes dhe vetëm 1% e tyre në industrinë e bazura në high tech. Shkalla e përhapjes së NVM-ve dhe sektorët e fokusimit të tyre, kanë një korrelcion me të ardhurat për frymë, por duket se në nivelin e të ardhurave 20.000-30.000 euro vendet kanë shkallën më të lartë të variacionit nga niveli më i ulët deri në nivelin më të lartë.

**Grafiku 2:** Pjesa e NVM-ve mikro, të vogla dhe të mesme në BE-28 dhe Shtetet Anëtare në 2018



*Shënim:* Përqindja e treguar pas etiketës së vendit është pjesa e mikro NVM-ve në popullsinë e përgjithshme të NVM-ve. Për arsye prezantuese, shkalla horizontale fillon nga 80%.

**Burimi:** Eurostat, Zyrat Kombëtare të Statistikave, DIW Econ


## NVM-të përballë vështirësive të krizës së Covid-19

Në dallim nga korporatat e mëdha të cilat kanë buxhete të mëdha për investime dhe për të mbështetur kërkim zhvillim për përdorimin e teknologjive të reja, NVM-të përballen me një sërë vështirësish si:

- (i) qasje të kufizuar në financa, shpesh e lidhur me mungesën e aftësisë likujduese që ato kanë;
- (ii) sfida nga rritja e konkurrencës e ndikuar nga ekonomitë e shkallës
- (iii) mungesa e bazasë së të dhënave,
- (iv) shpenzimet e ulëta për R&D, ndryshimin teknologjik dhe kufizimet e kapaciteteve që lidhen me njohuritë, inovacionin dhe kreativitetin;

**Aftësia për t'u përshtatur me ndryshimin e shpejtë të kërkesës së tregut apo kanalet e pazhvilluara të shitjeve janë disa nga arsyet e rritjes së ngadaltë të NVM-ve.**

**Grafiku 3:** Numri i NVM-ve në Shtetet Anëtare të BE-28 në 2018




*Shënim: Banorët e 15 viteve ose më shumë. GNI = të ardhurat bruto kombëtare, PPP = pariteti i fuqisë blerëse.*

**Burimi:** Eurostat, Zyrat Kombëtare të Statistikave, DIË Econ

Për shkak të faktorëve të sipër-përmendur NVM-të, përgjithësisht lidhur me pjesën e kërkimit shkencor, synojnë ta sigurojnë atë nga burime outsourcing dhe njëkohsisht të rritin kapacitetet e brendshme të kërkimit shkencor si një hap pozitiv drejtë strukturimit të aktivitetit të tyre në ekonominë e dijes ku mund të merret një vlerë e shtuar më e madhe dhe ku krizat dhe luhatjet e mëdha mund të amortizohen më lehtë.

**Grafiku 4:** Pjesa e NVM-ve të vogla dhe të mesme të BE-27, të cilat raportuan se kishin ndërmarrë aktivitete “in-house” në R&D ose aktivitete “outsourcing” në R&D të gjatë periudhës 2014-2016



*Shënim: Popullsia e NVM-ve në CIS përfshin vetëm ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Asnjë e dhënë nuk është në dispozicion për Mbretërinë e Bashkuar.*

**Burimi:** Eurostat - 2016 CIS


Aktualiteti në prani të Covid 19 do sjellë sfida të reja dhe jo të lehta edhe për NVM-të, prandaj këshillohet që këto biznese të kenë një strategji edhe zhvillim përballë konkurrencës në rritje. Më konkretisht inteligjenca artificiale, robotizimi, teknologjitë e avancuar në çdo sektorë të ekonomisë, shtuar edhe presionin në rritje që mund të sjellin krizat dhe epidemitë, kërkon një shift/kapërcim të aktivitetit të NVM-ve, nga shërbime dhe prodhime me vlerë jo të lartë, në sektorët e ekonomisë së dijës, ku ato mund të jenë më konkurrues dhe kontribuese.

Gjatë Covid 19 u qartësua se shumë shtete kërkuan adoptimin e aktivitetit të NVM-ve në prodhime apo shërbime me qëllim plotësimin të nevojave logjistike që mungonin në përballjen me të. Ky është një mësim për raste të tjera, pasi ndodh që në situatë krize të ringjallen qëndrime nacionaliste dhe vendet tradicionale eksportuese të pajisjeve mjekësore apo teknologjive të tjera të vendosin bllokim të përkohshëm të eksporteve për të plotësuar nevojat e tyre duke dobësuar vendet importuese të ketyre pajisjeve teknologjike apo prodhimit të mjeteve mbrojtëse të përditëshme. Fleksibiliteti që kanë NVM-të për të kaluar nga një linjë prodhimi në një tjetër të ngjashme rrit aftësinë konkurruese të tyre për tu përshtatur në kushtet e reja të prodhimit dhe për tu bërë faktir përcaktues për rimëkëmbjen e ekonomive në situata të tilla, ku tregu nuk operon në kushte normale.

## NVM-të përballë vështirësive të krizës së Covid-19

Në grafikun 5 konstatohet se mesatarisht NVM-të kanë një rritje vjetore në aktivitetin e produkteve me shkallë të lartë intesiteti tek ekonomia e dijes në rreth 4.7%, ku kompanitë mikro e shohin këtë fushë si sektorin e të ardhmes dhe kanë siguruar një shtesë vjetore në 5.4% ndërsa NVM në 4.6 % dhe ato të mesme në 3.7% në vit. Kompanitë e mëdha kanë një shtesë të re në 4.6%. Një nga avantazhet që ka fokusimi tek ekonomia e dijes është se ato kompani që konsiderohen mikro mund të jenë nënkontraktor të kompanive të mesme dhe të mëdha, në këtë mënyrë ato rriten gradualisht duke zënë vendin e tyre ose kalojnë në nivel më të larta ose blihen më shpejtë nga kompanitë e mesme dhe të mëdha.


**Grafiku 5:** Ndryshimi vjetor (%) në vlerën e shtuar në BE-28 NFBS sipas klasës së madhësisë së ndërmarrjeve në 2018



**Burimi:** Eurostat, Zyrtar Kombëtare të Statistikave, DIW Econ

E njëjta dinamikë konstatohet edhe në kontributet e tyre në punësim. Raporti i vlerës së shtuar gjatë një viti me rritjen e numrit të punonjësve ndihmon të kuptojmë efektet pozitive të rritjes së produktivitetit.

**Grafiku 6:** Ndryshimi vjetor (%) në punësim në BE-28 NFBS sipas klasës dhe madhësisë së ndërmarrjeve në 2018




**Burimi:** Eurostat, Zyrtar Kombëtare të Statistikave, DIW Econ

## NVM-të përballë vështirësive të krizës së Covid-19

Sigurisht që zhvillimi i NVM-ve, rritja e tyre në punësim dhe vlera e shtuar, na bënë që të identifikojmë pengesat kryesore të cilat ndryshojnë sipas vendeve të BE-së por edhe sipas sektorëve specifik ku ata janë fokusuar.

NVM-të të cilat janë fokusuar në sektorët që bazohen tek novacioni identifikojnë si vështirësitë kryesore: (i) kostot e larta; (ii) mungesë të burimeve të brendshme financimi; (iii) paqartësitë në kërkesat e tregjeve dhe (iv) konkurrenca e madhe.

**Grafiku 7:** Ndarja e NVM-ve inovative dhe jo-inovative të cilat i konsiderojnë çështjet e listuara si një problem të rëndësishëm



Burimi: Eurostat (CIS - 2016)

NVM-të përbëjnë pjesën më të madhe të rritjes së vlerës së shtuar (60%). Mikro NVM-të gjeneruan 28.5% të kësaj rritje, ndërsa NVM-të e vogla dhe të mesme llogariten përkatësisht 16.9% dhe 14.1%. Pjesëmarrja e NVM-ve në aktivitetet e inovacionit ndryshon shumë në të gjithë vendet e BE-28, me pjesën e ndërmarrjeve të reja të NVM-ve duke filluar nga 10% në Rumani në 66% në Portugal. Për BE-28, pjesa e inovacionit ishte gjyresisht e qëndrueshme nga 2004 në 2016.

Kjo shkakton një situatë të favorshme si për ofruesin ashtu edhe për konsumatorin. Për më tepër, kjo rrit produktivitetin e përgjithshëm, si dhe efikasitetin në të gjithë ekonominë. Studjues të ndryshëm kanë grupuar avantazhet dhe disavantazhet e NVM-ve si më poshtë.

### Avantazhet

1. Sipërmarrësit e rinj sjellin risi, ide dhe aftësi.
2. Vitet e fundit, NVM-të kanë regjistruar një normë më të lartë të rritjes në krahasim me sektorin industrial.
3. Avantazhi kryesor i sektorit të NVM-ve është potenciali i tij për të gjeneruar punësim me shpenzime të ulëta kapitale.
4. NVM-të veprojnë si një mbështetje kundër recesionit duke u përshtatur sipas rrethanave që ndryshojnë.
5. Ekziston një lidhje e fortë midis niveleve të ndryshme të varfërisë, urisë dhe mirëqenies ekonomike të shoqërisë dhe gjendjes së përgjithshme të NVM-ve.
6. Kur industritë e mëdha zvogëlojnë dhe ulin vendet e punës, NVM-të vazhdojnë të zhvillojnë dhe krijojnë më shumë vende pune.

7. NVM-të përshtaten shpejt në botën dinamike të biznesit duke kaluar në tregtinë elektronike pra transaksione në internet të mallrave dhe shërbimeve.
8. Përparimi në teknologji jo vetëm që ka lehtësuar procesin e shitjes dhe blerjes, por ka ndihmuar sipërmarrësit të ulin kostot e reklamimit dhe marketingut.
9. Platformat e ndryshme të tregtisë elektronike e bëjnë jetën e lehtë për NVM-të.
10. NVM-të luajnë një rol jetësor në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve të gatshme.
11. NVM-të kontribuojnë shumë në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm siç janë prodhimi, bujqësia dhe shërbimet e **TIK-ut**.
12. Ekziston një marrëdhënie reciproke midis një NVM-je dhe ekonomisë. Zhvillimi ekonomik siguron krijimin e më shumë NVM-ve. Nga ana tjetër krijimi i më shumë NVM-ve siguron një nxitje në ekonomi.

### **Disavantazhet**


1. Edhe pse punësimi i gjeneruar nga NVM-të është i madh, ato nganjëherë rezultojnë të jenë të përkohshme për nga natyra. Kjo për faktin se një numër i vogël i NVM-ve vdesin para se të kalojnë pragun pesë vjeçar. Kjo rezulton në papunësi të mëtejshme.
2. NVM-të janë kritikuar në të kaluarën për shkallën e tyre mahnitëse të falimentimit. Nëse produktet ose shërbimet e ofruara nga NVM-të nuk tregëtohen, ato dalin shumë shpejt nga biznesi.
3. Ndonjëherë për të mbijetuar dhe për të qenë në garë, NVM-të tejngopin tregun me produkte dhe shërbime të lira. Megjithatë prodhime të tilla mund të zëvendësojnë përkohësisht produktin origjinal, ato shpesh nuk mund të mbijetojnë nga konkurrenca. Kjo shkatërron plotësisht imazhin e markës dhe vlerën e NVM-ve.
4. Për më tepër, NVM-të kanë mungesë të kapitalit bazë të nevojshëm për krijimin, si dhe zgjerimin përtej një kufiri të caktuar..
5. NVM-të varen nga inovacioni për të mbijetuar. Sidoqoftë, presioni i vazhdueshëm për të përtëritur dhe krijuar mundësi të reja sjell pasiguri dhe konfuzion, por inovacioni mbetet alternativa më e mirë për të mbijetuar një NVM.
6. NVM-të kanë nevojë për një mjedis mbështetës dhe inkurajues për të mbijetuar.
7. Paqëndrueshmëria politike, si dhe rregullat e rrepta, të përcaktuara nga qeveria, kufizojnë krijimin dhe zhvillimin e tyre. Mund të ketë gjëra të shumta që mund të kufizohen për shkak të një vendimi të vetëm.
8. Kjo është arsyeja pse mbulimi i biznesit të dikujt me sigurimin e rrezikut është i nevojshëm.
9. NVM-të gjithashtu përballen me çështje të taksimit, nëse qeveria nuk i kushton shumë vëmendje krijimit të politikave miqësore ndaj sipërmarrësve.
10. Gjetja e një punonjësi të përshtatshëm për një punë të veçantë mbetet një sfidë e madhe për NVM-të. Njerëzit me përvojë janë ose shumë të shtrenjta për një NVM për të përballuar ose nuk duan të marrin rrezikun për të punuar për një biznes të vogël.
11. Qeveria mund të inkurajojë sipërmarrësit duke krijuar politika miqësore ndaj biznesit dhe mundësi të lehtë financimi.
12. Nëse mjedisi i biznesit është i favorshëm dhe mbështetës për bizneset e reja, ato jo vetëm që do të krijojnë më shumë punësim, por gjithashtu do të krijojnë një larmi produktesh dhe shërbimesh që konsumatori të zgjedhë.



## Rasti i Shqipërisë

Ne rastin e Shqipërisë NVM-të po ashtu luajnë një rolë shumë të rëndësishëm në aspektin ekonomik, duke krijuar mundësi të shumta punësimi si edhe duke u bërë motor zhvillimi për vendin dhe rajone specifike të tij.

**Grafiku 8:** Situata e NVM-ve midis viteve 2015-2018.



*Shenim: Për efekt studimi është krahasimi midis viteve 2017-2018*

*Burimi: Instat*

Statistikat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) bazuar në rezultatet e vërtetimit të Statistikave Strukturore, për vitin 2018, rezulton si më poshtë:

- ✓ 99,8 % të ndërmarrjeve aktive e zënë NVM, në të njëjtën përqindje si vitin e kaluar. Sektori i tregtisë ka peshën më të madhe të ndërmarrjeve NVM me 41,4 %, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 21,2 %. Përqindjen më të ulët e ka sektori i industrisë nxjerrëse dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me nga 0,6 % secili.
- ✓ 79,8 % e të punësuarve janë punësuar nga NVM nga 80,3 % që ishte në vitin e kaluar. Sektori i tregtisë punëson 29,0 % të NVM-ve, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 19,5 % dhe sektori i industrisë përpunuese me 18,4 %. Sektorët me numrin më të vogël të të punësuarve në NVM-të janë sektori i industrisë nxjerrëse me 1,8 % dhe sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 2,3 %.
- ✓ 77,4 % të shitjeve neto realizohen nga NVM nga 77,2 % të realizuara vitin e kaluar. Sektori i tregtisë mbizotëron me 52,4 % të shitjeve neto, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera me 11,5 % dhe nga sektori i ndertimit me 10,7 %. Sektori me përqindjen më të ulët të shitjeve të realizuara nga NVM-të është sektori i industrisë nxjerrëse me 2,1 %.
- ✓ 70,6 % të investimeve në vend kryhen nga NVM nga 60,1 % të kryera vitin e kaluar. Sektori me përqindjen më të lartë të investimeve të kryera në NVM-të është sektori i tregtisë me 24,3 %. Nga ana tjetër, sektori i transportit dhe komunikacionit ka përqindjen më të ulët të investimeve prej 4,3 %.
- ✓ Në Shqipëri numri i ndërmarrjeve në NVM është 99,8 %, i njëjtë me BE. Numri i të punësuarve në këtë grup ndërmarrjesh është 79,8 % në Shqipëri nga 66,6 % në BE. Vlera e shtuar e realizuar nga NVM në Shqipëri përbën 69,1 % nga 56,4 % në BE.

Nga rezultat e mësipërme si edhe ilustrimet grafike të publikuara nga instat për periudhën 2014-2018 shihet një trend rënës për sa i përket numrit të ndërmarrjeve të reja, megjithatë rëndësia në dy shtyllat

kryesore, zhvillim ekonomik edhe në punësim ngelet e konsiderueshme. Ndaj në një situatë si kjo e ditëve të sotme ku ekonomia e vendin është “paralizuar” për shkak të covid-19 do të nevojitet një ndërhyrje e menjëhershme nga ana e institucioneve kompetente, me politika fiksale edhe monetare. Kjo ndërhyrje është e nevojshme jo vetëm përgjatë periudhës por sidomos mbasë saj. Do të duhet një planë i mirëfilltë masash apo paketash ndihmëse për të ndihmuar që situatat të shkojnë sa më shpejt drejt normalitetit, duke reduktuar kështu kohëzgjatjen e një recessioni të mundshëm ekonomik.

Ashtu siç është thënë edhe më sipër, NVM-të orfrojnë një fleksibilitet për tu përshtatur edhe reaguaro shpejtë ndaj situatave të ndryshme, kjo gjë është dëshmuar edhe në vendet e tjera partnere me ne. Ndaj trajtimi me kujdes i tyre do të duhet që të mbetet një prioritet deri në përfundim të kësaj situatë, pasi kjo do të ndihmonte në mënyrë të njëpasnjëshme shtyllat e tjera të ekonomisë që të shkonin drejt normalitetit, pra kemi të bëjmë me një efekt zinxhirë mjaft të rëndësishëm. Studimi edhe përshtatja e eksperiencave nga vendet e tjera shihet si një mundësi potenciale për t’ju ardhur në ndihmë institucioneve politikë-bërse përgjatë kësaj periudhe, megjithatë nevojitet një bashkëpunim mjaft i mirë ndërmjet këtyre institucioneve në mënyrë që të kemi një zbatim praktikë sa më të mirë të masave të marra. Vlen për tu theksuar se problematikat që NVM-të përballen janë të ndryshme në vende të ndryshme, megjithatë problemet si: (i) mungesës së burimeve (financave, teknologjisë, punës së aftë, aksesit në treg dhe informacionit të tregut); (ii) mungesa e ekonomive të shkallës; (iii) kosto më të larta transaksionesh në raport me ndërmarrjet e mëdha; (iv) një paaftësi për të garuar kundër firmave më të mëdha për sa i përket shpenzimeve dhe inovacionit të R&D (produkti, procesi dhe organizimi) ngelen po të njëjta, ndaj duhet theksuar që në këtë kohë shkëmbimi i eksperiencave nga vende më të zhvilluara është mjaft i nevojshme.

Sidoqoftë, për shumë NVM, potenciali i tyre shpesh nuk realizohet plotësisht për shkak të faktorëve të sipër përmendur. Në mënyrë që NVM-të në Shqipëri të mbijetojnë gjatë dhe pas covid-19 duhet të mbështeten nga paketa antikrizë si:

1. Aksesim më të mirë për të financuar aktivitetin si grante, hua të buta dhe përjashtim të përkohshme nga taksat
2. Zhvendosjen e produkteve dhe shërbimeve nga bizneset e tyre në biznesin e virusit.
3. Mbrojtjet sociale - subvencione ose programet e trajnimit për të mbajtur aktivitetin hapur dhe për të ulur papunësinë.
4. Mbështetje për të riaktivizuar/adoptuar biznesin e tyre pas Covid-19
5. Dialog dhe kohezion shoqëror - bashkëpunim midis punë-dhënësve dhe punë-marrësve për të lehtësuar kostot e krizës duke ruajtur bizneset dhe të punësuarit.
6. Dialog dhe kohezion ndërinstinucional.

## Literatura

<https://www.interaksyon.com/breaking-news/2017/10/10/102488/employment-stagnation-in-NVMs-could-hurt-global-economy-ilo/>

<https://ieg.worldbankgroup.org/evaluations/world-bank-group-support-small-and-medium-enterprises-NVMs>  
Bell, S., 2015. <http://www.worldbank.org/en/topic/financialsector/brief/NVMs-finance>  
What are the biggest obstacles to growth of NVMs in developing countries? – An empirical evidence from an enterprise survey. <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2214845016300539>

Katua, D.N.T., 2014. Roli i NVM-ve në krijimin e punësimit dhe rritja ekonomike në vendet e zgjedhura. Revista Ndërkombëtare e Edukimit dhe Kërkimit, 2 (12), fq.461-72

Muritala, T., Awolaja, A. & Bako, Y., 2012. Ndikimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Revista Amerikane e Biznesit dhe Menaxhimit, 1 (1), fq.18-22

[https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/country\\_report\\_republic\\_of\\_montenegro.pdf](https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/country_report_republic_of_montenegro.pdf)

## **NVM-të përballë vështirësive të krizës së Covid-19**

---

Savlovsch, L.I. & Robu, N.R., 2011. Roli i NVM-ve në ekonominë moderne. *Economia. Menaxhimi i Serisë*, 14 (1), fq.277-81

Major Challenges Facing Small and Medium-sized Enterprises in Asia and Solutions for Mitigating Them.  
<https://www.adb.org/sites/default/files/publication/182532/adbi-wp564.pdf>

NVMs are more important than you think! challenges and opportunities for eu exporting NVMs

[https://trade.ec.europa.eu/doclib/docs/2014/september/tradoc\\_152792.pdf](https://trade.ec.europa.eu/doclib/docs/2014/september/tradoc_152792.pdf)

<https://cor.europa.eu/en/engage/studies/Documents/EU-NVMs/EU-policy-NVMs.pdf>

The NVM Instrument in action: an effective and innovative programme facing challenges.  
[https://www.eca.europa.eu/lists/ecadocuments/sr20\\_02/sr\\_innovation\\_NVMs\\_en.pdf](https://www.eca.europa.eu/lists/ecadocuments/sr20_02/sr_innovation_NVMs_en.pdf)

<http://www.instat.gov.al/media/6804/statistika-mbi-nd%C3%ABrmarjet-e-vogla-dhe-t%C3%AB-mesme-2018.pdf>